



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE**  
**DIASPORËS**

Nr. 1923 Prot

Vlorë, më 05.02 2025

Lënda: Mbi dëgjesat publike të zhvilluara nga Bashkia Vlorë për vitin 2024

**KRYETARIT TË BASHKISË**

**Z. Ermal Dredha**

Proçesi i njoftimit dhe i konsultimit publik në Bashkinë Vlorë gjatë vitit 2024 është bazuar në parimet e mëposhtme:

- a) Transparencë gjatë procesit të njoftimit dhe konsultimit publik
- b) Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese
- c) Efektshmëri e procesit të vendimarrjes në organet publike
- d) Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara

Proçesi është realizuar në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, neni 18, Ligji nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkërenduar me qëllim realizimin e një proçesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Gjatë vitit 2024 janë realizuar 16 dëgjesa me banorë në qytetin e Vlorës dhe njësive administrative përkatëse. Ndërkohë, për dëgjesat publike në kuadër të Buxhetit 2025, PBA 2025-2027 dhe Paketës Fiskale 2024, janë realizuar 10 takime të dokumentuara me procesverbal të plotë, pasqyruar në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Vlorë, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak dhe në mediat lokale të qytetit me edicione speciale.

Ky Raport Vjetor është hartuar nga Bashkia Vlorë në zbatim të detyrimeve që cakton për autoritetin publik neni 20 i Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Sipas

parashikimeve të këtij neni, organet publike hartojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit
- d) numrin e takimeve publike të organizuara.

➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2023**

Këshilli Bashkiak Vlorë miratoi gjithsej 113 vendime gjatë vitit 2024 të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë si dhe në platformën e personalizuar VENDIME.AL, në të cilën ato gjithashtu publikohen konform standartit të unifikuar të publikimit.

➤ **Rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit me palët e interesuara:**

Gjatë konsultimit u regjistruan në procesverbal 20 rekomandime.

➤ **Numri i rekomandimeve të pranuar:**

Nga 20 rekomandime, u mbajtën parasysht 15.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

Bashkia Vlorë njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun për PBA 2025-2027, Buxhetin 2025 dhe Paketa Fiskale 2025.

<https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimarrjes-me-pjesemarrje/>

Në Gusht 2024 Bashkia Vlorë publikoi njoftimin për hapjen e konsultimeve me publikun për PBA 2024-2026, Buxhetin 2025 dhe paketën fiskale 2025. Bashkia Vlorë zhvilloi në total 9 konsultime në kuadër të buxhetit 2024 dhe PBA 2023. Të gjitha procesverbalet e takimit gjenden në këtë link: <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimarrjes-me-pjesemarrje/>.

Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB nr.111 datë 27.12.2023 “Për buxhetin e bashkisë viti 2024”

2. Takimet konsultative për PBA 2024-2026, Buxhetin 2025 dhe Paketën Fiskale në Bashkinë Vlorë vijnë si më poshtë:

**2.1 Datë 10.09.2024/Njësia Administrative Shushicë-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjese publike në Njësinë Administrative Shushicë në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Nenkryetari i Bashkisë Vlorë z.Klevis Kaso. Pjesëmarrës ishin me shume se 20 persona, ndër ta ishin: Kryetari i Njësisë Administrative Shushicë – Birçe Aliraj; Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, Drejtore të Administratës së Bashkisë Vlorë, kryetar të fshatrave, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale. Fokus i diskutimit

ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Nenkryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë njësi administrative. Proçesi u dokumentuar me procesverbalin nr.14428 prot datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link : <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.2 Datë 11.09.2024/Njësia Administrative Novoselë-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjesë publike në Njësinë Administrative Novoselë në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 35 persona. Në takim mori pjesë deputeti Anduel Tahiraj, Kryetari i Njesisë Administrative Novosele –Kanan Shakaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, përfaqësues të KB, Drejtori i buxhetit dhe Financës-Kozma Mali, përfaqësues të Administratës së Bashkisë Vlorë, kryetarë të fshatrave të Njesisë Administrative Novoselë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për tu reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Kryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë njësi administrative. Proçesi u dokumentua me procesverbal nr.14426 prot datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.3 Datë 12.09.2024/Njësia Administrative Qendër-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjesë publike në Njësinë Administrative Qendër në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 24 persona, ndër ta ishin: nënkryetari i Bashkisë Vorë Klevis Kaso, Kryetari i Njesisë Administrative Qendër-Genard Fegaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, përfaqësues nga KB, Drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, Drejtori i buxhetit dhe finances Kozma Mali, kryetarë të fshatrave të Njesisë Administrative Qendër, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF locale. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Kryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë njësi administrative. Proçesi u dokumentua me procesverbal nr.14427 datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.4 Datë 09.09.2024/Njësia Administrative Oriku**m- Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjesë publike në Njësinë Administrative Oriku m në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 31 persona, ndër ta ishin: Kryetari i Njesisë Administrative Oriku m –Selim Haskocelaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, Drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, drejtori i buxhetit dhe finances Kozma Mali, kryetarë të fshatrave të Njesisë Administrative Oriku m, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF lokale. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Kryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë njësi administrative. Proçesi u

dokumentua me procesverbal nr.14429 prot datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.5 Datë 09.09.2024/Rajoni 1-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjese publike në Rajoni 1 në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Nënkryetari e Bashkisë Vlorë znj.Irena Toshkallari. Pjesëmarrës ishin rreth 17 persona, ndër ta nënkryetari i KB z.Novruz Rokaj, Kryetari i Rajonit 1- Skerdi Hunda, sekretar i KB z.Daut Zeraj, anëtar të KB, Drejtori i Buxhetit dhe Financës-Kozma Mali, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Nënkryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë rajon. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 14430 datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.6 Datë 11.09.2024 /Rajoni 4-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjese publike në Rajonin 4 në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 20 persona, ndër ta Kryetari i Rajonit 4- Donald Leskaj, Sekretar i KB z.Daut Zeraj, këshilltarë të KB, Drejtori i buxhetit dhe financës-Kozma Mali, drejtorë të administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Kryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë rajon. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 14433 datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.7 Datë 13.09.2024/Rajoni 5-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjese publike në Rajonin 5 në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Nënkryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 30 persona, ndër ta anëtar të KB, Kryetari i Rajonit 5- Bledar Toja, Drejtori i Buxhetit dhe Financës-Kozma Mali, përfaqësues të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, shoqeri civile dhe media. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për tu reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Nënkryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë rajon. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 14434 datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.8 Datë 11.09.2024/Rajoni 3-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjese publike në Rajonin 3 në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 60 persona, ndër ta ishin Kryetare e Rajonit 3- Manuela Prifti, Daut Zeraj-Sekretar i Këshillit Bashkiak, Drejtori i Buxhetit dhe Financës-Kozma Mali, përfaqësues të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Kryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë rajon. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 14432 datë

18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**2.9 Datë 10.09.2024/Rajoni 2-** Bashkia Vlorë zhvilloi dëgjese publike në Rajonin 2 në kuadër të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025. Ky takim u drejtua nga Nënkryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ishin rreth 50 persona, ndër ta ishin Kryetar i Rajonit 2- Orest Ruci; Drejtori i Buxhetit dhe Finances-Kozma Mali, përfaqësues të Administratës së Bashkisë Vlorë, anëtarë të këshillit bashkiak, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për të reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2025. Kryetari i bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë rajon. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 14431 prot. datë 18.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 30.01.2024 Bashkia Vlorë organizoi konsultimin me palët e interesit “Për tarifatat për shërbimet funerale në Bashkinë Vlorë.**

Ky takim u drejtua nga z. Ermal Dredha-Kryetari i Bashkisë Vlorë, znj.Elpinqi Mërkuri -Kryetare e Këshillit Bashkiak, përfaqësues nga administrate, anëtarë të KB, përfaqësues nga komunitetit dhe media locale. Fokus i diskutimit ishin tarifatat për shërbimet funerale në Bashkinë Vlorë sipas ndryshimeve pasi shërbimi do të kalojë nën administrimin e bashkisë Vlorë. Procesi u dokumentua me procesverbal nr.1526 datë 30.01.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 21.03.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik “Mbi rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë”**

Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha. Pjesëmarrës ndër ta ishin anëtarë të KB, përfaqësues nga bizneset, shoqëri civile dhe media. Fokus i diskutimit ishte rishikimi i nismës për dokumentin e PPV. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 4592 datë 27.05.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 17.04.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik “Rregulloren e shfrytëzimit të hapsirave publike (SPL) të Bashkisë Vlorë dhe Mbi procedurën e negocimit me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë Vlorë nëpërmjet marëveshjes për pronat në pronësi të bashkisë”**

Ky takim u drejtua nga Nënkryetarja e Bashkisë Vlorë znj.Irena Toshkallari, kryetarja e KB Elpinqi Mërkuri, Pjesëmarrës ndër ta ishin anëtarë të KB, përfaqësues nga bizneset, shoqëri civile dhe media. Fokus i diskutimit ishte mbi Rregulloren e shfrytëzimit të hapsirave publike (SPL) dhe pjesa e dytë e takimit kishte në fokus përcaktimin e procedurës së negocimit me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë Vlorë nëpërmjet marëveshjes për pronat në pronësi të bashkisë. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 6051 prot datë 22.04.2024 i cili

gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 29.04.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Përcaktimin e orareve të pastrimit përgjatë sezonit turistik”**

Ky takim u drejtua nga Nënkryetari i Bashkisë Vlorë z.Klevis Haso, Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, përfaqësues nga komuniteti dhe media. Fokus i diskutimit ishte mbi përcaktimin e orareve të pastrimit përgjatë sezonit turistik. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 7586 datë 16.05.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 16.05.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Reduktimin e zhurmave për Bashkinë Vlorë”**

Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Kryetarja e KB znj.Elpinqi Mërkuri. Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, përfaqësues nga komuniteti dhe media. Fokus i diskutimit ishte mbi planin e reduktimit të zhurmave për Bashkinë Vlorë . Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 7830 datë 21.05.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 20.05.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Miratimin e vendqëndrimeve të taksive dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Vlorë”**

Ky takim u drejtua nga Zëvendës kryetari i Këshillit të Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Kryetarja e KB znj.Elpinqi Mërkuri. Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, përfaqësues nga komuniteti dhe media. Fokus i diskutimit ishte miratimi i vendqëndrimit të taksive dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Vlorë si dhe reduktimin e zhurmave për Bashkinë Vlorë. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 8149 datë 27.05.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 16.08.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Miratimin e Planit të Përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të Bashkisë Vlorë”**

Ky takim u drejtua nga Kryetarja e Këshillit të Bashkisë Vlorë znj.Elpinqi Mërkuri, Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, përfaqësues nga komuniteti dhe media. Fokus i diskutimit ishte Miratimi i Planit të Përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të Bashkisë Vlorë. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 13216 datë 23.08.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>.

**Datë 20.09.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Miratimin e Shoqërisë Vlorë Parking sh.a. Përcaktimi I zonave të administrimit të parkimit në rrugë dhe esheshë në Bashkinë Vlorë”**

Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, përfaqësues nga komuniteti dhe media. Fokus i diskutimit ishte Miratimi i Shoqërisë Vlorë Parking sh.a. Përcaktimi i zonave të administrimit të parkimit në rrugë dhe sheshe në Bashkinë Vlorë. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 14852 datë 24.09.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>

**Datë 03.12.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Dhënien në përdorim të fondit kullorosr Shashicë Gumenicë në pronësi të Bashkisë Vlorë për veprimtari fotovoltaike”**

Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, Drejtori i Drejtorisë Juridike -Dorian Demiri, banorë të zonës, kryeplaku i fshatit Kaninë dhe media. Fokus i diskutimit ishte dhënia në përdorim të fondit kullorosr Shashicë Gumenicë në pronësi të Bashkisë Vlorë për veprimtari fotovoltaike. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 19680 datë 05.12.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>

**Datë 16.12.2024/Bashkia Vlorë zhvilloi konsultimin publik për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 në Bashkinë Vlorë”**

Ky takim u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Pjesëmarrës ndër ta ishin drejtorë të administratës, përfaqësues nga komuniteti dhe media. Fokus i diskutimit ishte miratimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 në Bashkinë Vlorë. Procesi u dokumentua me procesverbal nr. 20353 datë 18.12.2024 i cili gjendet në këtë link <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>

**KOORDINATORE PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK**

Albana Naçi

